

PËR NJË NDRYSHIM NË VKB-NË NR. 61, DATË 19.08.2022 “PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 80, DATË 02.12.2021 “PËR PËRCAKTIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR ATO NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË”

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 dt.17/12/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 8, neni 9, pika 1, nën pika 1.1, gërmat “a” dhe “b”, nenin 29, pikat 3 dhe 4, nenin 33, pika 1, shkronja “ç”, nenin 54 shkronja “k”, neni 55, pika 2 dhe 6; Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative” Ligjit Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; Ligjin Nr. 74/2025 “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.26, datë 31.03.2023 “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Vlorë 2023-2028”, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës _____ 2026,

VENDOSI:

1. Pika 1 të ndryshojë si më poshtë:

Oraret e hedhjes së mbetjeve urbane gjatë periudhës së sezonit turistik, do të jenë si më poshtë:

- Për qytetarët orari i hedhjes së mbetjeve do të jenë fashat orare:

ora 06:00 deri në orën 10:00

ora 19:00 deri orën 23:00.

- Për subjektet fizik dhe juridik, orari i hedhjes së mbetjeve do të jenë fashat orare:

ora 15:00 deri në orën 16:30

ora 23:00 deri në orën 03:00.

Oraret e hedhjes së mbetjeve urbane jashtë sezonit turistik, do të jenë si më poshtë:

- Për familjarët orari i hedhjes së mbetjeve do të jetë në fashën:

ora 06:00 deri në orën 10:00

ora 19:00 deri në orën 22:00.

- Për subjektet fizik dhe juridik, orari i hedhjes së mbetjeve do të jetë në fashën, si më poshtë:

ora 06:00 deri në orën 09:00

ora 21:00 deri në orën 23:00.

2. - Të shtohet pika si më poshtë:

Bizneset si supermarketet, restorantet, hotelet, familjet, subjektet private dhe publike, që krijojnë mbetje gjatë veprimtarisë së tyre të natyrës si:

1. Mbeturina ushqimore (organike, nga restorantet etj)
2. Amballazhe (plastike, qelq, letër, karton, veëanerisht nga marketet, supermarketet etj)
3. Metalike të përmasave të vogla.

Dorëzimi ditor i mbetjeve urbane në një volum më të madh se 1/4 e volumit të një konteneri publik është i ndaluar sipas këtij vendimi, për rrjedhojë të gjitha bizneset apo institucionet privatë apo shtetërore që prodhojnë mbetje mbi kufizimin e lejuar, duhet të kenë detyrimisht hapësirë individuale brenda territorit të tyre ku kryhet aktiviteti, dhe duhet ti mbledhin me qeska të mbyllura ose kosha të vetë biznesit.

Kartonat të jenë të palosura dhe të sistemuara në anë të kontenerëve ose të mbahen në brendësi të biznesit deri në orarin e hedhjes së tyre në vendet e miratuara.

Për mbetjet jo urbane (inerte, orendi shtëpiake, pajisje zyrash etj), heqja dhe grumbullimi i tyre, të bëhen në bazë të një grafiku të miratuar nga Ndërmarrja e Pastrimit Vlorë.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, kryetari dhe strukturat përkatëse të Bashkisë Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015“Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55, pika 6.